



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:155581  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05435389

**C.nr.332/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil**, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike-civile të paditëses B. K. S. nga Prishtina, kundër të paditurit A. H. nga Komuna e Podujevës, baza e kontestit Rimbursim dëmi, në vlerë kontesti prej 2,235.00 Euro, jashtë seancës me datë 11.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HUDHET POSHTË** padia e paditëses B. K. S. nga Prishtina, kundër të paditurit A.H. nga Komuna e Podujevës, për Rimbursim dëmi në vlerë prej 2,235.00 Euro.

**A r s y e t i m**

Paditësja kundër të paditurit ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt.03.08.2019, lidhur me çështjen për Rimbursim dëmi.

Në adresën e shënuar në padi nga paditësi gjykata nuk ka mundur që të paditurit ti dorëzojë Aktvendimin për përgjigje në padi të datës 01.11.2023, ngase fletë kthesa e gjykatës është kthyer me konstatimin e dt.27.11.2023 se dorëzimi i provua pala gjendet jashtë vendit deklarojnë të afërmit.

Për këtë arsye, gjykata në Aktvendimin e datës 04.12.2023 të cilin paditësja e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datën 13.12.2023, në kuptim të dispozitës së nenit 99 lidhur me nenin 102 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), paditësit ia kthen padinë në plotësim dhe përmirësim me qëllim të cilësimit të drejtë dhe saktësimit të adresës së të paditurit e në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Me nenin 391 par.1 pika g) të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), është përcaktuar se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: ; g) paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 të këtij ligji.”*

Meqë gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë së paditësit për shkak se paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk e ka plotësuar dhe përmirësuar padinë sipas aktvendimit të lartshënuar, andaj në pajtim me nenin 102.3 dhe 391 par.1 pika (g) të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i përgjithshëm  
C.nr.332/2019 të datës 11.03.2024**

**Gjyqtari:**  
Nazmi Neziri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesë në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.